



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:095627

Datë: 05.06.2023

Numri i dokumentit: 043..37

C - III. – 16 - 0178

Paditësit :

I N dhe Xh J që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit e të cilët me autorizim i përfaqëson, av S R nga Prizreni.

Kundër

Të paditurit:

NSH, Kombinati Bujqësor Industrial, KBI“Progres Export“, NSH.“Blegtoria - Lavërtaria”, dhe Industria e Fijeve Sintetike, IFS, ”Progres” me seli në Prizren e të përfaqësuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr.”Dritan Hoxha”nr.55, Lagjja, ”Lakrishtë”, Prishtinë; A L nga Prizreni e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. P P nga Prizreni; F I I I N dhe N Xh trashëgimtarë të të ndjerit, Xh Xh nga fshati L Komunës së Prizrenit; Gj,A dhe V K që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit F K nga fshati L i Komunës së Prizrenit; S B nga fshati L i Komunës së Prizrenit;I H nga fshati L i Komunës së Prizrenit; M,B, n,S, S N, trashëgimtarë të të ndjerit B N, T Z dhe S N trashëgimtarë të të ndjerit, S N nga Beogradi,..; J J,F M dhe T N etj.

Për : Palët.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (Dhoma e Posaçme), me Kolegjin e saj në përbërje prej gjykatësit, Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësit, Gazmend Sylaj dhe gjykatëses, Hajrie Shala, antarë të kolegjit, në seancën vendimarrëse të mbajtur me **dt.05.06.2023**, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar propozimi i paditësve, I N dhe Xh J që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit për anulimin e masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010.

II. ANULOHET – lihet jashtë fuqie, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010 e me të cilin është caktuar masa e përkohshme me ndalesë të tjetërsimit të ngastrës kadastrale me nr... e evidentuar sipas certifikatës mbi të Drejtat në paluajtshmëri nga ana e Zyrës Kadastrale të Kosovës – Zyra Kadastrale në Prizren, nr.UL – ..., ZK L.

III. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), do të vazhdoj procedurën e vendosjes për shqyrtimin e pjesës tjetër të padisë në lëndën, C – III. – 16 – 0178 dhe atë sipas padisë së paditësve, I N dhe Xh J që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit të paraqitur kundër të paditurave, NSH, Kombinati Bujqësor Industrial, KBI“Progres Export“, NSH.“Blegtoria - Lavërtaria”, dhe Industria e Fijeve Sintetike, IFS, ”Progres” me seli në Prizren dhe atë për ngastrat tjera kadastrale : ngas.kad.nr...në sipërfaqe prej 2,56.00 ha, sipas list.pos.nr... ZK L, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,05.20 ha, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,03.39 ha, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,04.38 ha, sipas list.pos.nr... ZK L, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,13.27 ha, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,14.80 ha, sipas list.pos.nr... ZK L dhe par.kad.nr... në sipërfaqe prej 1,75.20 ha, sipas list.pos.nr..., ZK L, dhe parc.kad.nr... në sipërfaqe prej 1,75.20 ha, sipas list. pos.nr... ZK L dhe të cilat janë objekt i padisë së paditësve.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me dt.20.06.2005, paditësit, fillimisht në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (Dhoma e Posaçme), kanë paraqitur padinë kundër të paditurave NSH, Kombinati Bujqësor Industrial, KBI“Progres Export“, NSH.“Blegtoria - Lavërtaria”, dhe Industria e Fijeve Sintetike, IFS, ”Progres” me seli në Prizren e të përfaqësuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe atë për vërtetimin e pronësisë, ndalimin e privatizimit si dhe kthimin e pronësisë pasardhësve të ish pronarit dhe se kjo lëndë pranë DHPGJSK-së, ka qenë e regjistruar me numrin, SCC – 05 – 0191 derisa kjo gjykatë me aktvendimin e saj, SCC- 05 – 01 – 191 të dt.26.10.2005, ka caktuar që Gjykata Komunale në Prizren me kompetencë lëndore për vendosje në këtë kontest.

Paditësit, kësaj padie, ia kanë bashkangjitur provat gjegjëse që kanë qenë pjesë e lëndës, C.nr.1041/05 derisa dt.07.12.2009, Gjykata Komunale në Prizren, me aktgjykimin e saj, C.nr.1041/05 të dt.07.12.2009, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, I N dhe Xh J që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit, ka vërtetuar se paditësi në bazë të trashëgimisë janë pronar të një pjeses të parc.kad.nr...në sipërfaqe prej 2,56.00 ha, sipas list. pos.nr..., ZK Lubizhdë, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,05.20 ha, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,03.39 ha, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,04.38 ha, sipas list. pos.nr... ZK L, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,13.27 ha, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,14.80 ha, sipas list. pos.nr... ZK L dhe par.kad.nr... në sipërfaqe prej 1,75.20 ha, sipas list. pos.nr... ZK L, gjë që të paditurat, KBI, “Progres Export“, NSH.“Blegtoria - Lavërtaria”, dhe IFS, ”Progres” me seli në Prizren, duhet t’u pranojnë dhe ka obliguar të paditurën e parë, që paditësve, t’ua dorëzoj në posedim këto parcela kadastrale: një pjesë të parc.kad. kad.nr... në sipërfaqe prej 1,14.80 ha, sipas list.pos.nr..., KK L, në masa dhe kufij gjegjës, një pjesë të parc.kad.nr...në sipërfaqe prej 2,56.00 ha,

sipas list.pos.nr..., KK L në masa dhe kufij gjegjës, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,05.20 ha, sipas list.pos.nr..., KK L në masa dhe kufij gjegjës, par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,03.39 ha, sipas list.pos.nr..., ZK L në masa dhe kufij gjegjës, parc.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,04.38 ha, sipas list. pos.nr... ZK L në masa dhe kufij gjegjës dhe par.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,13.27 ha,

sipas list.pos.nr..., KK L në masa dhe kufij gjegjës dhe që e paditura e parë, të lejoj që parcelat e lartëcekura në sipërfaqen e lartëcekur të regjistrohen në emër të paditësve, si bashkëpronar të të njëjtave në secilin nga ata me nga 1/3 (një e treta) e pjesës ideale në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren derisa ka obliguar edhe të paditurën e dytë, IFS "Progres" nga Prizreni, që paditësve, t'ua dorëzoj në posedim parc.kad.nr... në sipërfaqe prej 1,75.20 ha, sipas list. pos.nr... ZK L në masa dhe kufij gjegjës që e paditura e dytë, të lejoj që parcelat e lartëcekura në sipërfaqen e lartëcekur të regjistrohen në emër të paditësve, si bashkëpronar të të njëjtave në secilin nga ata me nga 1/3 (një e treta) e pjesës ideale në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren kurse një pjesë të kërkesëpadsisë së tyre e të cilët kanë kërkuar dallimin në sipërfaqe prej 2,56.00 ha gjer më 5 hektar nga parc.kad.nr., ZK L, e ka refuzuar si të pa bazuar e më gjerësisht ka vendosur si në këtë aktgjykim.

Pas ushtrimit të ankesës së të paditurës, AKP-së të dt.31.03.2010 kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Komunale në Prizren e për DHPGJSK-së, dhe pas dërgimit të shkresave të kësaj lënde me aktin e saj, C.nr.527/14 të dt.17.10.2014 në Dhomën e Posaçme, Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së, me aktvendimin e tij, AC – II- 12 – 0207 të dt.07.07.2016, ka aprovuar ankesën e të të paditurës, ka anuluar aktgjykimin, C.nr.1041/05 e dt.07.12.2009 të Gjykatës Komunale në Prizren, dhe lëndën ia ka dërguar Kolegjit përkatës specializuar për ri gjykim e më gjerësisht ka vendosur në këtë aktvendim.

Me dt.18.11.2016, e paditura, AKP-ja, ka paraqitur mbrojtjen e saj në padinë e paditëse e në të cilën në mes tjerash, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditësve për njohjen e të drejtës së pronësisë në ngastrat kadastrale të cekura në padi e që kanë qenë objekt i kontestit.

Me dt.24.02.2021, av. P P nga Prizreni, i autorizuar i të paditurit, A L në lëndën, C.nr.1041/05 e cila është në zhvillim e sipër në Gjykatën Komunale në Prizren e sipas padisë së paditësve të njëjtë si këtë lëndë pranë DHPGJSK-së, i është drejtuar Dhomës së Posaçme me parashtrësën e palës së paditur e sipas së cilës parashtrësë, me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010, ka caktuar masën e përkohshme kundër të paditurit, A L nga Prizreni, për ndalimin e tjetërsimit të ngastrës kadastrale me nr... në sipërfaqe prej 2546 m² dhe se gabimisht kjo lëndë është bartur në DHPGJSK dhe se përmes kësaj parashtrëse ka kërkuar që të shpallet jo kompetente dhe shkresat e lëndës sa i përket të paditurit, A L, t'i dërgohen Gjykatës Themelore në Prizren, si gjykatë kompetente për të vendosur dhe se kësaj parashtrëse ia ka bashkangjitur: kopjen e parashtrësës së tij të dt.23.06.2011 për lëndën, C.nr.1041/05, e cila ka qenë në zhvillim e sipër në Gjykatën Komunale në Prizren e sipas padisë së paditësve të njëjtës si këtë lëndë pranë DHPGJSK-së, i është drejtuar Dhomës së Posaçme me në lëndën, SCC – 05 – 0191 e që DHPGJSK-ja, të merr aktvendim për ndarjen e lëndës sipas padisë së paditësit, Ibrahim Jashari etj të paraqitur kundër të paditurit, A L nga Prizreni që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë për ngastrën në fjalë, kopjen e aktvendimit, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010 të Gjykatës Komunale në Prizren e me të cilin provohet për ngastrën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 2546 m², ZK L, është

caktuar masa e përkohshme me ndalesë të tjetërsimit të kësaj parcela e cila është pronësi të të paditurit, A L nga Prizreni, kopjen e përgjigjes së AKP-së, Zyrës Rajonale në Prizren të adresuar tek personi quajtur, R L nga Prizreni përkitazi me atë se kjo ngastrë nuk evidentohet në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve) dhe si e tillë nuk është në menaxhimin e AKP-së në Prizren, pra pjesë e kësaj lënde, është edhe ngastra kadastrale nr... në sipërfaqe prej 2546 m², ZKL(sipas

evidencës kadastrale, pronar i saj është, A L nga Prizreni) dhe se sipas përgjigjes së të paditurës, AKP-së të dt.05.01.2021, kjo ngastër nuk evidentohet në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve) dhe si e tillë nuk është në menaxhimin e AKP-së në Prizren, dhe kopjen e certifikatës së dt.29.01.2021 të lëshuar nga Zyra Komunale Kadastrale në Prizren për evidencën kadastrale të kësaj ngastreje.

Me dt.10.03.2021, av. P P nga Prizreni, i autorizuar i të paditurit, A L në lëndën, C.nr.1041/05, sërish i është drejtuar Dhomës së Posaçme e duke e njoftuar se i paditur, A L ka vdekur dhe se ka kërkuar nga kjo gjykatë që të procedohet më tej e me qëllim që trashëgimtarët e të njëjtit, t'a realizojnë bartjen e të drejtës së pronësisë në emrin e tyre për këtë ngastër kadastrale e më gjerësisht si në këtë parashtrësë.

Me dt.29.04.2011, av.S R nga Prizreni, i autorizuar i paditësve, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën e dt.27.04.2021 e përmes së cilës kërkon nga gjykata që pjesën e padisë dhe masën e përkohshme me C.nr.1041/05 prej dt.08.01.2010 lidhur me veç ngastrën kadastrale nr...ZKL– Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme me e tërhequr ndërsa për të tjerat ngastra nga padia të mbetet në fuqi deri në përfundimin e kontestit.

Me dt.16.12.2022, DHPGJSK-ja, si gjykatë, me Urdhrin e saj, C – III – 16 – 0178 të dt.16.12.2022, ka urdhëruar paditësit, që të bëjnë precizimin e parashtrësës së dt.29.04.2021, dhe se pas pranimit të këtij urdhri, i autorizuar i paditësve, me dt.10.1.2023, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën e dt.04.01.2023 e në të cilën në mes tjerash sqaron për rrjedhën e procedurës së deritanishme edhe sipas padisë së bërë ndaj këtu paditësve nga këtu i padituri, A L në Gjykatën Komunale në Prizren për patundëshmërinë në ngastrën në fjalë si dhe në mes tjerash i ka propozuar gjykatë që të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010, në lëndën, C.nr.1041/05 e me të cilin është caktuar masën e përkohshme për ngastrën gjegjëse kadastrale e më gjerësisht si në këtë parashtrësë dhe se të njëjtës ia ka bashkangjitur, draftin e kontratës interne të dt...të lidhur në mes këtu paditësve dhe trashëgimtarëve të të paditurit, A L nga Prizreni për shitëblerjen e patundëshmërisë në ngastrën kadastrale nr..., ZK Lubizhdë.

Me dt.23.1.2023, DHPGJSK-ja, si gjykatë, sërish me Urdhrin e saj, C – III – 16 – 0178 të dt.23.1.2023, ka urdhëruar paditësit, që të deklarohen dhe sqarojnë se a mbesin pranë parashtrësës së dt.29.04.2021 e me të cilën kanë propozuar që veç për ngastrën kadastrale nr...ZKL– Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme me e tërhequr ndërsa për të tjerat ngastra nga padia të mbetet në fuqi deri në përfundimin e kontestit.

Me dt.01.02.2023, autorizuar i paditësve, i është drejtuar kësaj gjykate, me parashtrësën e dt.30.1.2023 e përmes së cilës, e njofton gjykatën se qëndron pranë parashtrësës së dt.29.04.2021 dhe ka theksuar se e tërheq padinë e tij ndaj të paditurit, A L nga Prizreni lidhur me ngas.kad.nr..., në vendin e quajtur, "Kaldrma", me kulturë, "arë" edhe e cila ka sipërfaqe prej 2546 m² ZKLsi dhe i ka kërkuar, Dhomës së Posaçme me e qit jashtë fuqie masën

e përkohshme – sigurisë lidhur me ngas.kad.nr...në sipërfaqe prej 2546 m² ZKL– Prizren pasi që paditësit dhe i padituri, kanë lidhur marrëveshje pranë Gjykatës Themelore në Prizren dhe lënda u përfundua .

Me dt.14.02.2023, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), me aktvendimin e saj, C – III. – 16 – 0178 të dt.14.02.2023, ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e pjeshme të padisë së paditësve të paraqitur ndaj të paditurit, A L nga Prizreni, dhe se padia e paditësve për një pjesë të padisë së tyre, është konstatuar pjesërisht e tërhequr.

Me dt.23.05.2023, I autorizuari i paditësve, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtresën e dt.15.05.2023 e përmes së cilës në mes tjerash ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që me aktvendim të veçantë, t'a hedh poshtë masën e përkohshme e cila është shpall me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010 lidhur veq për ngastrën kadastrale me nr... për sipërfaqen prej 2546 m², ZK L, Prizren.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmbajnë propozimi për anulimin e masës së përkohshme, dhe për juridiksionin dhe se gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Juridiksioni i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar me nenin 5 dhe 6 të Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në bazë të nenit 5 të Ligjit, Nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet, Juridiksioni i kësaj gjykate e në të cilin thuhet se: *''Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim: ... çdo parashtresë për vlerësimin dhe vendosjen e ligjshmërisë së një Aktgjykimi apo Aktvendimi të lëshuar nga një gjykatë tjetër në Kosovë në lidhje me kërkesat apo lëndët e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni''*.

Po ashtu në nenin 76 par.3 të të Ligjit, Nr.06/L-086 të DhPGJSK-së, parshihet se: *''Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore''*.

Në nenin 309 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e dispozitat e të cilit ligj, sipas nenit 76 par.3 të të Ligjit, Nr.06/L-086 të DhPGJSK-së, parshihet se: *''Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit''*.

Pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës, Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme të Kosovës, vlerësoj se :

Propozimi i paditësve, I N dhe Xh J që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit për anulimin e masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010, është i bazuar,

Në rastin konkret kemi të bëjmë me padinë e paditësve e me të cilën kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë, ndalimin e privatizimit si dhe kthimin e pronësisë, pasardhësve të ish pronarit mirëpo në ndërkohë, av. P P nga Prizreni, i autorizuar i të të paditurit, A L në lëndën, C.nr.1041/05 e cila është në zhvillim e sipër në Gjykatën Komunale në Prizren e sipas padisë së paditësve të njëjtë si në lëndën, C – III. – 16 – 0178 pranë DHPGJSK-së, i është drejtuar Dhomes së Posaçme me parashtrësën e tij e në cilën parashtrësë, ka theksuar se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010, për ngastrën kadastrale, nr... në sipërfaqe prej 2546 m², ZK L, është caktuar masën e përkohshme kundër të paditurit, A L nga Prizreni, dhe atë për ndalimin e tjetërsimit të kësaj ngastreje kadastrale dhe se gabimisht kjo lëndë është bartur në DHPGJSK dhe se përmes kësaj parashtrëse, ka kërkuar që Dhoma e Posaçme, të shpallet jo kompetente dhe shkresat e lëndës sa i përket të paditurit, A L, t'i dërgohen Gjykatës Themelore në Prizren, si gjykatë kompetente për të vendosur për këtë pjesë së padisë së paditësve.

Mirëpo në ndërkohë edhe vet paditësit, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën e dt.15.05.2023 e përmes së cilës në mes tjerash ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që me aktvendim të veçantë, t'a hedh poshtë masën e përkohshme e cila është shpall me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010 lidhur veç për ngastrën kadastrale me nr... për sipërfaqen prej 2546 m², ZK L, Prizren dhe se Kolegji i DhPGHJSK-së, vlerëson se edhe pse kemi të bëjmë me çështjen pronësore, patundëshmëria për ngastrën kadastrale me nr..., ZK L, Prizren, është e evidentuar në emër të njërit nga të paditurit, A L nga Prizreni, e jo në emër të të paditurës, AKP-së, se paditësit pranë DhPGJSK-së, e kanë tërhequr padinë ndaj të të paditurit, A L nga Prizreni, dhe se DhPGJSK-ja, me aktvendimin gjegjës të saj, ka dhënë pëlqimin për këtë tërheqje, se palët ndërgjyqëse – trashëgimtarët e të paditurit, A L nga Prizreni dhe paditësit, në procedurën jashtëgjyqësore, kanë lidhur kontratë interne për shitëblerjen e patundëshmërisë në fjalë, për shkak të respektimit të parimit të efikasitetit të procedurë si dhe se meqë i autorizuari i paditësve, ka kërkuar që të hedhet poshtë masa e përkohshme e të cilin propozim të paditësve, kjo gjykatë, e ka konsideroj si propozim për anulimin e masës së përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010, andaj edhe konstatoj se propozimi i paditësve, I N dhe Xh J që të gjithë nga fshati L i Komunës së Prizrenit për anulimin e masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1041/05 të dt.08.01.2010, është i bazuar dhe të njëjtin aktvendim, e anuloj – la jashtë fuqie derisa kjo gjykatë, do të vazhdoj procedurën për

të vendosur për pjesën tjetër të padisë së paditësve në lëndën, C – III. – 16 – 0178 për patundëshmëritë e ngastrave tjera kadastrale e të cilat janë objekt i këtij kontesti pranë pranë DHPGJSK-së.

Nga të gjitha që u thanë më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, 5, 6, 9, 61 dhe nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të

Kosovës (DHPGJSK) lidhur me nenin 297, 304, 305 dhe nenin 309 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
2023:095627, 05.06.2023

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Gazmend Sylaj, Gjykatës _____

Hajrie Shala, Gjykatëse _____

KËSHILLË JURIDIKE:

Në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për DHPGJS-në, Ankesa - Apeli kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJSK-së dhe atë në afatin prej **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimin të këtij aktvendimi